

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zhblokohen procedurat, Bashkia e Tiranës merr në dorëzim apartamente të reja për strehimin social, zbatohet kontributi 3% i ndërtuesve Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/zhbllokohen-procedurat-bashkia-e-tiranes-merr-ne-dorezim-apartamente-te-reja-per-strehimin-social-zbatohet-kontributi-3-i-ndertuesve/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 12:59:49 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 12:50:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	75dddf6f94bfd36dec23f94a7b989d6cc44a46c8422dd6864188403ea59b2186
TEKSTI	c623bd55fb75256852c8a9dfb31a9d79f1fa6b61982096489e3df027fdaae93f
PAMJA	d6bd8450c124d33f483a4cb474de9ff5c3c529be9b28dec26810c2b9381be8fd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f64cae16dbd0e035c69ebf39eb26ad6ac60ff58068131e7fef3cfe831435d5de
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f64cae16dbd0e035c69ebf39eb26ad6ac60ff58068131e7fef3cfe831435d5de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Aktualitet

Zhbllokohen procedurat, Bashkia e Tiranës merr në dorëzim apartamente të reja për strehimin social, zbatohet kontributi 3% i ndërtuesve



Edi Hallaci

16 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

Bashkia e Tiranës ka marrë në dorëzim apartamente dhe njësi shërbimi në Njësinë Administrative nr. 11, të cilat i shtohen fondit publik të pronave të destinuara për programet sociale të strehimit.

Pas zhbllokimit të procedurave, përfaqësues të Bashkisë së Tiranës ishin të pranishëm gjatë procesit të marrjes në dorëzim të apartamenteve, të cilat janë të certifikuar dhe të përfunduara sipas standardeve të parashikuara në projekt.

“Sot marrim në dorëzim apartamentet në zbatim të kontratës së lidhur mes Bashkisë së Tiranës dhe subjektit ndërtues. Apartamentet janë të certifikuar, në gjendje shumë të mirë dhe plotësojnë standardet e projektimit dhe të zbatimit të punimeve. Janë të gatshme për banim dhe nga sot kalojnë në administrimin e Bashkisë së Tiranës”, u shprehën përfaqësuesit e Bashkisë gjatë procesit të dorëzimit.

Ata sqaruan se këto apartamente janë pjesë e mekanizmit të parashikuar gjatë procesit të lejeve të ndërtimit, përmes të cilit sektori privat kontribuon në krijimin dhe zgjerimin e fondit publik të banesave sociale.

Apartamentet e përfutuara përmes këtij mekanizmi përdoren në kuadër të programeve të strehimit social dhe u shërbejnë individëve dhe familjeve që plotësojnë kriteret ligjore për përfitim. Bashkia e Tiranës administron ndër të tjera programin e banesave sociale me qira, ndërsa në procedurat e saj parashikohet posaçërisht edhe përdorimi i apartamenteve që i janë shtuar fondit publik si rezultat i kontributit 3% të sektorit privat.

Marrja në dorëzim e apartamenteve në Njësinë Administrative nr. 11 vijon zbatimin e këtij

mekanizmi, duke shtuar asetet publike që Bashkia e Tiranës mund të vendosë në dispozicion të politikave të strehimit dhe familjeve që kanë më shumë nevojë për mbështetje.

LAJME TË NGJASHME



I akuzuar për vrasje të mbetur në tentativë, Gjykata e Tiranës vendos ekstradimin e shtetasit turk në Zvicër

1.5 MIN



Protestë te Zogu i Zi, policia shoqëron disa persona/ Vështirësuan qarkullimin!

1 MIN



Goditen 3 raste të prostitucionit në Tiranë, në pranga 4 persona

1 MIN



Të plakesh në shtëpinë tënde? Ja sa mund të kushtojë përshtatja e banesës!

2.5 MIN



Lezhë, tritol portës së një banese/ Policia nis hetimet!

1 MIN

MË TË LEXUARAT



Sot verdikti i Hagës/ Konjufca: Presim vetëm një vendim, lirin e katër ish-krerëve të UÇK-së



Charles Smith kryeson trupin gjyqësor në Hagë



Trupi gjyqësor: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Gjykata speciale në Hagë jep sot vendimin për Thaçin dhe ish-krerët e tjerë të UÇK-së



Kush janë gjyqtarët që do të shpallin sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së në Hagë?



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Ky është monoliti më i madh në Afrikë dhe një nga më të mëdhenjtë në botë...

EDITORI SUGJERON





Një natë, shumë ritme dhe një ndalesë që nuk e kishim planifikuar!



Nga dëshira për të prekur "Eurovisionin" deri tek situata më e sikletshme në koncert, flet Lorenc Hasrama!



"Po sikur...?" Ja si mendimet më të zakonshme na fusin në alarm...



"Po du", Rilind Alimani tregon si arriti të realizojë bashkëpunimin me Elvana Gjatën: I kam shkruar që...



Truku i thjeshtë që ua heq lekurën specave pa mundim, mjafton një hap pas pjekjes!



"Eksperimentova, shkoi shumë mirë"/Egri Tako flet për projektet e saj muzikore: Do kthehem tek baladat...



Të dobët dhe e keni të vështirë të shtoni pesë?! Proveni këto ushqime...



Të gjithë po shtojnë ekrane, Range Rover po bën të kundërtën!



Jeni të mërziut?! Bëni mirë të hani këto ushqime...



Mendoni se partneri juaj po ju tradhton?! Ja se si duhet të flisni me atë...

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktoni
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav widget](#) to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.